

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-1
K 31

Shefki Karadaku

poezi

UJĘVARĘ

854-1
K 31.

TO NËSHTRU
OLAT NË VITIN

Shefki Karadaku

UJËVARË

poezi

33472

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

PËR NE, DYZETVJEÇARËT

Për ne, dyzetvjeçarët, koha pati se ç'të thotë,
dyzet vjet në jetën e njeriut janë shumë ...
Socializmi, që na rriti,
diti se ç'të na japë dhe të na kërkojë pastaj;
ne qemë A-ja e revolucionit dhe kënga e të
rënëve,
ne ditëm se ç'të bënim!
Fatet që zgjodhëm u ndanë si degë peme,
fëmijët e gjizës u bënë njerëz me peshë në
pushtet;
dikë e privilegjoj koha për t'u bërë shofer,
dikë e ngriti në piedestalin e shkrirësit, si Korab;
fryma që na mëkoi buka
e thatë me shëllirë dhe kokrra e qepës
u bë fryma e darkave jubilare.
Qepët e fëmijërisë u servirën në pjata gresi,
misri u bë franxhollë.
Për të ndërtuar qytete me apartamente luksoze
më parë ne ndërtuam kasollet e lirisë;

uzinat nisën në thikën e partizanit,
fëmijët në rininë e humbur të Persefonit,
darkat e pasura në çyrekun e ndarë pambarimisht.

Ne kemi se ç'të themi!

B R E G D E T A S E

Diç nga Vlora më mbeti në letër,
hap lirikat e detit të madh,
fryn nga vargu i vjetër Zvérneci,
Kus-Babai buzëqesh si përrallë.

Zgjohen rrugët e qeta të mbrëmjes,
pranë, uji
bankinat rrëmih,
unë vija nga kodrat ushtare
me një grusht Shkumbini në shpirt.

Më gëzonin fytyrat gazmore,
lumturia e tyre e qetë;
ndaj ëndërroja për vjersha madhore
kur lirikat valëzonin si det

Vrisja mendjen për trope të gjera,
kur buzëqeshja e njerëzve s'kish fund,
gjersa kokën e ndieja të rëndë
nga mesnata që derdhej mbi kum.

E mendoja, e ndieja se jeta
më e fortë figurë më ish;
sot nga vargu i vjetër fryn era
plot lirika vlonjate në shpirt.

NISJE DREJT SHQIPËRISË

Nga një bisedë shqiptarësh në një aeroport të huaj.

Zhurmon për herë të fundit rok-end-rolli në veshët tanë,

megafoni u zhduk nën avionin që u nis;

ne pak nga pak

të çliruar nga ankthi

qeshëm me gëzim...

Shyqyr, tha një shqiptar,

tani do të vemi te këngët tona të thjeshta;

më ka marrë malli për kabatë përmetare,

e dini?

BALADA E KOMUNISTIT

Balada e komunistit është e thellë,
balada e tij shkëlqen si zjarr.
Kur erdhi perandori që përtej detit
atë e kérkoi në shi e në acar.

E kérkoi perandori i Romës nëpër qytete
dhe ulériu pastaj se ku fshihej ai
dhe ia kthyen perandorit: ai lufton për njerëzit,
me zemrën e tyre rreh dhe zemra e tij.

E kérkoi perandori në fshatrat e thella
dhe ulériu ai se ku jetonte vallë
dhe ia kthyen perandorit: nëpër këngë kérkoje,
nëpër këngë shkëlqen shpirti i tij i gjallë.

E kérkoi ai nëpër dimrin e tmerrshëm.
Ku ka më të kobshëm se dimri i ngrirë?
Por ia kthyen perandorit: ai në akull endet,
ai në akull ngryset gjersa lufton i lirë.

E kërkoi perandori nëpër arat e mjera
dhe mendoi ai se uria ul çdo kokë,
por ia kthyen perandorit: ai ha bukë egjëre
dhe si dielli mëkon me dashuri këtë tokë.

Ku është ai atëherë, perandori klithi,
që ta nis të lidhur si skllav në Romë?
Dhe ia kthyen perandorit: na këto batare trimi
dhe nisu çalë-çalë në qivur si kufomë!

M A R G A R I T A

E thërrisin Margaritë. Nuk ishte
Margarita e «Faustit», por e nënës së saj;
në lagjet plot lot të Beratit njozu diellin,
flokët e tij u bënë flokët e saj të bukur;
në sy i pati yjet dhe këngët në gojë.
...e thërresim Margaritë...

E thërrisin Margaritë. Nuk ishte
Margarita e «Faustit», por e atdheut të saj;
i donte shtëpitë të bardha, njerëzit të qeshur,
çamarrokët me lule. Dhe për këtë një ditë
e kapën fashistët dhe e futën në qeli.
...e thërresim Margaritë...

E thërrisin Margaritë. Nuk ishte
Margarita e «Faustit», por e Partisë së saj;
e donte atdheun të bukur me diell mbi grurë,
qytetet të lumtura dhe punëtorët liriplotë
dhe për këtë fashistët i dhanë një plumb të zi.
...e thërresim Margaritë...